



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:033739

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05740814

P.nr.733/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit, J.G., për shkak se ka kryer veprën penale, *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269, par.2, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 5188/2019 e datës: 28.02.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë: 22.04.2024, ku morën pjesë, Prokurorja e Shteti Rukije Shasivari, si dhe i akuzuari J.G., ndërsa me datë: 23.04.2023, mori dhe shpalli, kurse me datë 14.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J.G. , i biri i G dhe nënës S, e gjinisë B, i lindur me “data e lindjes”, nga Prishtina rr “-----”, ku edhe jeton, me nr personal “letërnjoftimi”, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr tel ---

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Më datë 20.10..2019 rreth orës 15:30 min, në Prishtinë në rrugën “Malush Kosova”, i pandehuri J.G., pa autorizim ka poseduar, substancë narkotike më peshë të përgjithshme prej,1.2 gram e cila iu është gjetur në veturën e tij pas kontrollit nga ana e policisë e për të cilën, sipas ekspertizës është vërtetuar se është substancë narkotike e llojit marihuane.

-me çka ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269, paragrafi. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 269 paragrafi 2 lidhur më par.3 të KPRK-së dhe neneve 242 par.2, 269, 276. 358, 364, dhe 365, të KPPRK-së, të akuzuarit i gjykon me:

DENIM ME GJOBË

- I. Të akuzuari J.G., i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) Euro, të cilën gjobë është i obliguar të paguan në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke e llogaritur, 20 (njëzet) Euro me 1 (një) ditë burgim.
- III. URDHËROHET- konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 1.2 gram, konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.
- IV. Obligohet i akuzuarit që, t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50.00 (pesëdhjetë) Euro, për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

Rrjedha e procedurës, Historiku:

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.5188/2019 e datës: 28.02.2020, kundër të akuzuarit, J.G., për shkak se ka kryer veprën penale, “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269, par.2 të KPPRK-së.

Kompetenca e gjykatës:

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas pranimit të aktakuzës, ka bërë vlersimin e kompetencës, andaj duke u bazuar në nenin 29 paragrafi.1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në rr “Malush Kosova” në Prishtinë e që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate. Duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku i akuzuari akuzohet për shkak të veprës penale , “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269, par.2 të KPPRK-së, e cila vepër është e dënueshme deri në 1 (një) vit burgim, andaj bje në kompetencë lëndore të këtij departamenti.

Shqyrtimi gjyqësor:

Gjykata pas analizimit dhe vlersimit të aktakuzës, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë: 22.04.2024, ku gjatë kësaj seance kanë qenë prezent Prokurorja e Shteti Rukije Shasivari, si dhe i akuzuari J.G., ku i akuzuari pasi që jan lexuar të drejtat e tij në harmoni me nenin 241 të Kodin e Procedurës Penale nga ana e gjykatës, ka theksuar se don që të deklarohej.

I akuzuari J.G., në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar, duke theksuar se e pranon se është fajtor, ka qenë hera e parë, si dhe ndihet i penduar.

Prokurorja e Shtetit Rukije Shasivari, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar, duke theksuar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, si dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merr si rrethanë lehtësuese.

Vlerësimi mbi pranimin e fajësisë:

Andaj gjykata me aktvendim pranoi, pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, për shkak të veprës penale, *“Posedimi i paaautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”* nga neni 269, par.2, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrenguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPRK-së.

Rikualifikimi i veprës penale:

Gjykata pasi që ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ka vrenjtur se i akuzuari J.G., sipas aktakuzës, PP/II.nr.5188/2019 e datës: 28.02.2020, akuzohet për veprën penale *“Posedimi i paaautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”* nga neni 269, par.1, të KPPRK-së, sipas përshkrimit se i njëjti ka pasur në posedim narkotik të llojit kanabis marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 1.2 gram, e cila duhet të ri-kualifikohet në veprën penale *“Posedimi i paaautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”* nga neni 269, par.2, të KPPRK-së, pasi që nga paragrafi 2 citohet se: *“Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*, andaj mbi bazën e kësaj, si dhe në harmoni me nenin 359. par 2 të KPPRK-së, ku citohet se: *Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës, gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale.*

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale:

Se i akuzuari J.G., me datë 20.10.2019, rreth orës 15:30 në rrugën “Malush Kosova” në Prishtinë, nga njësi policor është ndaluar i pandehuri J.G. dhe pas një kontrole nga ana e zyrtarëve policor të Kosovës është gjetur dhe konfiskuar substancë narkotike e llojit Marihuana në peshë të përgjithshme 1.2 gram të cilën substancë e ka poseduar pa autorizim me qëllim të konsumimit personal. Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, për veprimin e tillë të kundërligjshme, sipas këtyre veprime është vërtetuar që janë përberë në tërësi elementet e veprës penale, *“Posedimi i paaautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope apo analoge”* nga neni 269 par.2 të KPRK-së. nga par.2 citohet se: *“Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*. Gjykata nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e tij, si dhe deklarimi i prokurorit duke e pranuar pranimin e fajësisë, po ashtu nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka konstatuar se janë përmbushur elementet e veprës penale, ashtu siç është përshkruar në aktakuzën e lartcekur.

Shqiptimi i sanksionit penale:

Gjykata me rastin e matjes së dënimit mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, po ashtu pendesa e ti sepse ka qenë hera e parë që kishte kryer veprën penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti faktin se i pandehuri me dashje ka poseduar substanca narkotike në mënyrë të kundërligjshme, ashtu siç përshkruhet në aktakuzën e cila i vihet në barrë, andaj gjykata duke i marrur për bazë rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese të akuzuarit i shqiptohet dënimi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që, i akuzuari kishte në posedim narkotik të llojit (Marihuan) që me peshë prej 1.2 gram të cilin e kishte për konsumim personal, ashtu siç është përshkruar në aktakuzën e cila i vihet në barrë për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope apo analoge” nga neni 269 par.2 të KPRK-së. Gjykata mbi bazën e kësaj dhe më bindje të lire të akuzuarit i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) Euro, të cilën gjobë është i obliguar të paguan në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Qëllimi i dënimit:

Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi konfiskimin e substancës narkotike:

Urdhërimi i konfiskimit të përhershëm i substancës narkotike të llojit kanabis marihuanë, që përmban me peshë të përgjithshme prej 1.2 gram, është bërë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, ku nga paragrafi.3 citohet se: “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”. Si dhe lidhur me dispozitat e nenit 276 të KPRK-së, pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit nga par.1 citohet se: “*Pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet konfiskimit, në cilëndo fazë të procedurës nga gjyqtari kompetent, pa marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit dhe pavarësisht nëse prokurori i shtetit e ka ndërmarrë apo jo ndonjë veprim për ta konfiskuar pasurinë. Poseduesi, shfrytëzuesi ose i pandehuri nuk ka të drejtë ankese*”, ndërsa nga par.2 pika 2.4 citohet se: *kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 267-274 të Kodit Penal*, andaj gjykata mbi bazën e kësaj ka bërë konfiskimin e substancës narkotike.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1, dhe par.2 të KPPRK-së. ku nga paragrafi .1 citohej se: *Kur gjykata e shpall të akuzuarin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.*

Baza ligjore mbi të cilën u vendos sipas këtij aktgjykimi:

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 269 paragrafi 2 lidhur më par.3 të KPPRK-së, si dhe neneve 242 par.2, 269, 276, 358 dhe 364, 365, 452, 462, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.733/20, datë: 14.05.2024

Bashkëpunëtori profesional:
Asdren Selmani

Gjyqtari:
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.